



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Nr. 1256-3/1257-2
Datë: 22.10.2021

Komisioni për licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë - BPrAL i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave të nenit 11 paragrafi 3 dhe 4, nenit 14, 15 paragrafi 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 si dhe në bazë të neneve 5, 6, 7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë dhe në bazë të kërkesave për licencim nga BPrAL- Kolegji "Globus" nr. 1256 dhe nr. 1257, dt. 27.07.2021, si dhe vendimit nr. 1994/2 datë 13.10.2021 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Bartësit Privat i Arsimit të Lartë (BPrAL) – kolegji "Globus" në Prishtinë dhe dega në Podujevë, i refuzohet kërkesa për licencim.
2. BPrAL – kolegjit "Globus", i lejohet t'i përcjell studentët e viteve paraprake për përfundimin e provimeve sipas vendimit për ref. 449/18D, i datës 18.05.2018 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, konkretisht pika II, apo sipas nenit 12 pika 5 e Ligjit për Arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.
3. I ndalohet tërësisht transferi i studentëve sipas programeve apo viteve të studimit.
4. Vendimi hyn në fuqi më nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave të cekura më lartë, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si dhe në funksion të vendimit nr. 1994/2 i datës 13.10.2021 të nxjerrë nga znj. Fadile Dyla, zv. sekretare e MASHTI-t, shqyrtoi kërkesën me nr. 1256 dhe 1257 të dt. 27.07.2021 të parashtruar nga kolegji "Globus" për ripërtëritje të licencës.

Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës të parashtruar nga kolegji "Globus", vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kushtet për rilicencim, sepse nuk ka arritur të riakreditohet

në nivel institucional për të dytën herë radhazi, sipas vendimit nr. 986/20D datë 21.07.2020 dhe vendimit nr. 2802/21 datë 19.07.2021 të lëshuara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

Sipas nenit 15 paragrafi 7 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë nr. 04/L-37 datë 29.08.2011 citon: "Nëse dështon për herë të dytë në marrjen e akreditimit, atëherë i hiqet licenca".

Meqenëse BPrAL / kolegji "Globus" sipas Vendimit ref. 449/18D i datës 18.05.2018 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, konkretisht pika II, i akredituar dhe pastaj edhe i licencuar nga MASHTI kishte regjistruar studentë me kushte dhe kritere të këtyre dy dokumenteve atëherë komisioni për Licencim i merr parasysh të dhënat e parashtruara në ato dokumente dhe ia lejon aktivitetin sipas asaj që është cekur në pikën 2 të këtij vendimi.

Ndryshe, edhe funksionimi i bartjes së studentëve në ndonjë institucion tjetër sipas marrëveshjes në mes të dy institucioneve tani me hyrjen në fuqi dhe aktivizimin e sistemit SMIAL, nuk është e realizuar, sepse i tejkalohet me automatizëm numri i studentëve kolegjit i cili mund ti pranoj studentët e kolegjit tjetër dhe si e tillë konsiderohet joligjore për kolegjin, që i ka pranuar ata studentë.

Kolegji "GLOBUS" nuk ka asnjë të drejtë të veprojë lidhur me transferin e studentëve për asnjë vit akademik apo program studimi nga marrja e këtij vendimi.

Komisioni duke marrë parasysh faktet e lartcekura, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, Sekretarit të përgjithshëm të MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Sekretarit të përgjithshëm, MASHTI;
2. Arkivit të MASHTI;
3. Parashtruesit të kërkesës;
4. DALSHT;
5. DNJBIA;
6. Inspektoratit të Arsimit, MASHTI.

Kryetar i Komisionit

Burim Gashi